3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën. Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë Operatori Ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

**10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave**

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

**D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE**

**11. Paraqitja e Ofertave**

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, Operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për Furnizimin e Mallrave; Njoftimi Nr. \_\_\_.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ----- d/m/v, në orën-----” .**

**12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur

të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

**13. Ofertat me vonesë**

Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i Prokurimit Elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

**14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në çdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit, të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

**15. Hapja e Ofertave**

Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

**E. SHQYRTIMI I OFERTAVE**

**16. Konfidencialiteti**

Autoriteti/enti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

**17. Sqarimi i ofertave**

Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

**18. Përgjegjshmëria e ofertave**

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;

- (b) **“Rezervim”** është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) **“Mospranim”** është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

## F. VLERËSIMI I OFERTAVE

### 19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik

1. Për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret, për të cilat nuk lejohet vetëdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

### 20. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

#### **Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

$P_o$  - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$  - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

**a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:**

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{mink1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:**

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

$V_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

### **Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme.

### **21. Konvertimi në valutë të vetme**

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.



**22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht te ulët**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
  - b) garanci bankare;
  - c) garanci nga shoqëri sigurimi.

## DH. ANKESAT

### 25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

### 26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

---

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>3</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<sup>3</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

## Shtojca 2.

*[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>4</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.



6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

**Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:**

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

**Shtojca 3.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					

---

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

#### Shtojca 4.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*  
*[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

## Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

## Shtojca 6.

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### LOTI 1: ICD VR

Nr.	Materiali mjeksore me specifikimet teknike	Njësia
1*	<b>ICD VR- single chamber implantable defibrillator with defibrillation lead, Peelable Percutaneous Lead 7F Introducer and technical support during implantation</b> ICD-VR defibrilator i implantueshem nje dhomesh bashke me sonden e defribilitimit, introduktore per futjen e sondes se pacemakerit si dhe teknikal support during implantation) <b>ICD VR – single chamber implantable defibrillator including the following features: - maximum delivered energy at least 35 Joules, algorithms for discrimination of SVTs from VTs algorithm for monitoring lead integrity with patient alert and ability of automatic reprogramming of VF detection parameters in case of alert, trends for heart variability, daily heart rate and daily activity, 3 arrhythmia detection zones (VT, fast VT and VF) , programmable Active Can, sound or vibration alarm in case or battery depletion or any other condition, lead fracture, diagnostics features: episodes, markers and EMG Defibrillation lead, steroid, active fixation, with 2 defibrillation coils, choice of different length, Sheeth-introducer peel away for introducing electrode (including guide wire, syringe, dilator, needle and introducer).</b> ICD-VR defibrilator i implantueshem nje dhomesh qe permban edhe karakteristikat e meposhteme: energjia e “leshuar” te pakten 35 joules, algoritma per diskriminimin e SVTs nga VTs,t e dhena per “heart variability”, frekuencen ditore dhe aktivitetin ditor, 3 zona te zbulimit te aritmive (VT, VT e shpejte dhe VF) , active Can i programueshem,alarm me ze ose vibrim ne rast te mbarimit te baterise ose fracture te sondes ose te nje problem tjeter, karakteristika te programueshme: episodet, treguesit dhe EMG, Sonde defibrilimi steroide me fiksime aktiv me 2 coil defibrilimi, me zgjedhje minimumi te 3 gjatesive,Introduktore per futjen e sondes se pacemakerit me funksion (qe perfshijne guiden, shiringen, dilatorin, agen dhe introduktorin .	Copë
2*	<b>ICD-DR – dual chamber implantable defibrillator with compatible defibrillation lead, compatible atrial lead and 2 sheath (9 and 8 sheath) and technical support during imp</b> (ICD-DR – defribillator kardiak i implantueshem, dy dhomesh implantable defibrillator, me sonden ventrikulare dhe atriale kompatible si dhe me 2 sheath (9 dhe 8 french) si dhe support teknik gjate implantimit) <b>ICD-DR – dual chamber implantable defibrillator with compatible defibrillation leads with the charecteristic: Maximum delivered energy for HV therapy not less than 35J for all shocks, Arrhythmia detection in 3 zones (VT, FVT and VF), ATP therapy delivered before and during the capacitor charging, Automatic pacing mode switch from AAI(R) to DDD(R) and vice versa or algorithm for RV pacing minimization, Wireless communication with programmer, Programmable active SVC coil and active can for VF shock delivery, SVT discriminator based on far-field morphology, At least 2 algorithms for reducing unnecessary shocks in addition to SVT discriminators, sound or vibration alarm in case or battery depletion or any other condition,</b> ICD-DR – defribillator kardiak i implantueshem,dy dhomesh implantable defibrillator, me sonden ventrikulare dhe atriale kompatible qe ka keto karakteristika: Energjia maksimale e shkarkuar per terapine me voltazh të lartë (HV) jo më pak se 35J për të gjitha goditjet, Detektim aritmie në 3 zona (Takikardi Ventrikulare (TV), Takikardi Ventrikulare e Shpejtë (TVS)dhe Fibrilacion Ventrikular(FV)) ,Ndërrim automatik i modalitetit të pejsimit nga AAI(R) në DDD(R) dhe anasjelltas për minimizimin e pejsimit në Ventrikulin e Djathtë, Komunikim Wireless me programuesin, ,Diskriminues i Takikardisë Supraventrikulare bazuar në morfologjinë far-field , Të paktën 2 algoritme për reduktimin e shkarkimeve të panevojshme krahas diskriminuesve të Takikardisë Supraventrikulare, alarm me ze ose vibrim ne rast te mbarimit te baterise ose fracture te sondes ose te nje problem tjeter,	Copë
3	<b>PEEL WAY</b>	Copë
4	<b>Pacing system analyser (PSA) restiriliable patients cable compatible with programer</b> (Kabell i resterilizueshem qe lidhet me programatorin dhe sherben si analizator per matjet gjate implantimit te pacemakerit	Copë
5	<b>Paper for programer</b> (leter per programatorin)	Copë

#### LOT 2 - MRI IPG FOR PHYSIOLOGICAL PACING/ GJENERATORE PULSI TE IMLANTUESHME MRI PER PEJSIM FIZIOLOGJIK

Nr.	Materiali mjeksor me specifikimet teknike	Njësia
-----	---	--------

1	<p><b>Pacemaker VVIR-rate adaptive implantable pulse generator with technology that allows safe MRI imaging for the patient in the magnetic fields of 1.5 T and 3 T + independent programming of frequency adaptability for the zone of normal and for the zone of high physical load + automatic recognition of the moment of implantation and polarity of the electrode + automatic reprogramming of the stimulation polarity and sensing polarity + ventricular pacing lead with active or passive fixation.</b> ( Pacemaker VVIR- gjenerator pulsi i implantueshem me ritem te adaptueshem qe lejon pacientin te kryej imazhin MRI i sigurte ne fushen magnetike 1.5 T dhe 3 T. + programim i pavarur i adaptimit te frekuences per zonen normale dhe per zonen me ngarkese te larte fizike +njohje automatike e momentit te implantimit dhe polaritetit te elektrodes + riprogramim automatik i polaritetit te stimulimit dhe polaritet te njeshmerise + elektrode ritmi ventrikulare me fiksion pasiv ose aktiv)</p>	copë
2	<p><b>Pacemaker DDDR- atrio-ventricular rate adaptive implantable pulse generator with technology that allows safe MRI imaging for the patients in the magnetic fields of 1.5 T dhe 3 T+ automatic adjustment of stimulation voltage depending on the measured pacing threshold + automatic adjustment of sensitivity in both heart chambers + algorithm for extension of AV delay for minimisation of ventricular pacing + ("rate drop response" algorithm for recognition and therapy of vasovagal syncope) + independent programming of frequency adaptability for the zone of normal and for the zone of high physical load + trend of electrode impedance + recording of intracardiac electrograms + switching from bipolar to unipolar stimulation in case the pacing impedance is outside the set values + atrial and ventricular pacing leads with active or passive fixation.</b> (Pacemaker DDDR- gjenerator pulsi i implantueshem me ritem te adaptueshem atrio-ventrikular me teknologji qe lejon pacientin te kryej imazhin MRI i sigurte ne fushen magnetike 1.5 T dhe 3 T + rregullim automatik i tensionit te stimulimit ne varesi te pragut te pacimit + rregullim automatik i ndjeshmerise ne te dy dhomat e zemres + algoritem per zgjatjen e voneses AV per minimizimin e pacimit ventrikular + algoritem pergjigje te renies se ritmit per njohjen dhe terapine e sinkopes vazovagale + programim i pavarur i frekuences per zonen normale dhe per zonen e ngarkeses se larte fizike + te kete trend te impedances se elektrodes + rregjistrim i elektrogrames intrakardiake + konvertim nga stimulim bipolar ne unipolar ne raste se impedanca e pacimit eshte jashte vlerave te vendosura + elektroda ritmi atriale dhe ventrikulare me fiksion aktiv ose pasiv)</p>	copë
3	<p><b>Pacemaker VVIR MRI with active leads with antibiotic antibacterial envelope for implantable devices designed to reduce the risk of infection. Single chamber pacemaker with programmable pacing polarity (unipolar and bipolar), amplitude threshold test, lead impedance trend (graph of daily measured lead impedance vs. time), and automatic pacing polarity switch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range (for example in case of lead fracture), recording and storage of IEGM. Steroid eluting ventricular pacing lead with 50 % are active fixation and 50 % are with passive fixation. Antibiotic antibacterial envelope for implantable devices designed to reduce the risk of infection. + possibility of full body absorption + elution of minocycline and rifampicin + possibility of multiple envelope size choice.</b> Pacemaker nje - dhomeshe MRI qe programon polaritetin e pejsimit (njepolar dhe bipolar), test te pragut te amplitudes, grafikun e impedances se sondes (grafik ditor i vlerave te impedances se sondes vs kohes), dhe kalimi i polaritetit te pejsimit nga bipolar ne unipolar ne rast se vlera e impedances se sondes eshte jashte intervalit te programuar (per shembull ne rast te demtimit te sondes, rregjistrimi dhe ruajtja e IEGM.) Sonde ventrikular pejsimi e veshur me steroid ku 50 % jane sonda me fiksion pasiv dhe 50 % me fiksion aktiv. Zarf antimikrobial me antibiotik per aparate te implantueshem i dizenuar per uljen e infeksionit, me mundesi absorbimin e plote, i veshur me minocikline dhe rifampicine, mundesine e zgjedhjes se zarfeve me madhesi te ndryshme.</p>	copë
4	<p><b>Pacemaker DDDR MRI with corresponding active leads with Antibiotic antibacterial envelope for implantable devices designed to reduce the risk of infection. Dual chamber pacemaker rate responsible with: automatic active capture control in atrium and ventricle depending on measured pacing threshold, programmable pacing polarity (unipolar and bipolar), amplitude threshold test, lead impedance trend (graph of daily measured lead impedance vs. time including bipolar lead storage of intracardiac electrograms,EGM storage. Atrial and ventricular Steroid eluting pacing lead with active fixation. Antibiotic antibacterial envelope for implantable devices designed to reduce the risk of infection. + possibility of full body absorption +elution of minocycline and rifampicin + possibility of multiple envelope size choice.</b> Pacemaker DDDR MRI me: kontroll automatik i captures ne atrium dhe ne ventrikul nga matja e pragut te pejsimit, polaritet pejsimi te programueshem (unipolar dhe bipolar), test te pragut e amplitudes, trend te impedances se elektrodes (grafik i matjes ditore te impedances ne raport me kohes), magazinimin elektrogrames intrakardiake. Sonde atriale dhe ventrikulare pejsimi e veshur me fiksion aktive. Zarf antimikrobial me antibiotik per aparate te implantueshem, i dizenuar per uljen e infeksionit, me mundesi absorbimin e plote, i veshur me minocikline dhe rifampicin, mundesine e zgjedhjes e zarfeve me madhesi te ndryshme.</p>	copë
5	<p><b>Sheeth-introducer peel way for introducing permanent pacemaker electrode (including guide wire, syringe, dilator, needle and introducer) 8 F.</b> Intraduktore qe mund te hiqet per futjen e sondes se pacemakerit me punction (qe perfshijne guiden, shiringen, dilatorin, agen dhe intraduktorin 8 F</p>	cope
6	<p><b>Electrodes for temporary pacing with external pacemaker 5 or 6 F.</b> Elektroda per pejsim te perkohshem me pacemaker te jashtem 5/6 F</p>	cope
7	<p><b>Paper for programmer.</b> Leter per programatorin</p>	Cope

8	<b>Disposable large alligator clip style extension with safe connect used for temporary pacing procedures/sterilized.</b> Kabell me 2 dalje me krokodila qe lidhet me pacemakerin e jashtem / I sterilizueshem)	cope
9	<b>Pacing system analyser (PSA) restiriliabile patients cable compatible with programer.</b> Kabell I risterilizueshem qe lidhet me programatorin dhe sherben si analizator per matjet gjate implantimit te pacemakerit.	cope
10	<b>Lumenless lead for stimulation of HIS bundle + electrode body diameter 4.1 Fr. + multiple lengths + technology that allows safe MRI imaging for the patient in the magnetic fields of 1.5 T and 3 T.</b> Elektrode pa lumen per stimulimin e HIS bundle, diametri i trupit te elektrodes 4.1 Fr, gjatesi te ndryshme, me teknologji qe lejon pacientin te kryeje imazhe MRI i sigurte ne fushen magnetike 1.5 T dhe 3 T	cope
11	<b>Catheter for HIS bundle electrode placement and fixation with fixed curved. Possibility to select different curves and catheter lengths.</b> Kateter per vendosjen dhe fiksimin e elektrodes se HIS bundle me forme fikse, mundesi per te zgjedhur forma dhe gjatesi te ndryshme	cope
12	<b>Deflectable catheter for HIS bundle electrode placement and fixation. Possibility to select different catheter lengths.</b> Kateter I devijueshem per vendosjen dhe fiksimin e elektrodes se HIS bundle, mundesi per te zgjedhur gjatesi te ndryshme.	cope

### LOTI 3 - BIVENTRICULAR PACEMAKER (CRT-P)

Nr.	Materiali mjeksor me specifikimet teknike	Njësia
1	<b>Biventricular pacemaker (CRT-P) Compound of: 1- CRT Device; 2- Active Atrial Lead; 3- active Ventricular Lead; 4- CS Lead unipolar/bipolar; 5- CS cannulation catheter set; 6- Venogram Balloon catheter for coronary sinus; 7- Introducer 3pcs; 8- technical support and PROCTOR during implantation.</b> CRT-P device including the following features: 1-Separate programming of pacing parameters (amplitude, pulse width) for LV and RV, at least 4 or 5 different programmable vectors for LV lead pacing , Programmable interventricular stimulation interval, Automatic lead polarity switch from bipolar to unipolar in case of lead impedance out of preset range, Possibility of parallel printing of diagnostic trends such as AT/AF daily burden, percentage of pacing, Algorithm for supression atrial fibrillation by atrial pacing in sinus rhythm, Pulmonary congestion detection and monitoring, 2-Steroid eluting atrial pacing lead with active fixation, 3-Steroid eluting ventrikular pacing lead with active fixation, 4-Bipolar steroid eluting lead for left ventricle stimulation through coronary sinus. Implantation over the wire, possibility of choice of different distal end curves 5-Catheter for LV introduction into coronary sinus, possibilty of choice of different distal end curves.6- Accesory set for LV introduction into coronary sinus which consists of : guidewire, slitter tool, syringe and torque,7-Balloon catheter for coronary sinus venogram with possibility of introduction over-the-wire, 8- 3 Sheeth-introducer peel away for introducing electrode (including guide wire, syringe, dilator, needle and introducer), 2 size 7-8 F, one size 9 F.1-Pacemaker-i CRT-P duhet te pletesoje specifikat e meposhteme: Programim i vecante i parametrave te pejsimit (amplitudes, gjerese se pulsit) per VM dhe VD., te pakten 5 vektore te ndryshem te programueshem te eletrodes LV te pejsimit Interval i stimulimit interventrikular i programueshem. - Nderim automatik i polaritetit te sondes nga bipolare ne unipolare ne rastin kur impedanca eshte jashte kufirit te parapercaktuar. - Mundesi e printimit paralel te prirjeve diagnostike, si gakeses ditore te TA/FA, frekuences ventrikulare gjate TA/FA, perqindjes ditore te pejsimit - Algoritmi per nderpererjen e FA nepermjet pejsimit atrial ne ritem sinusal. - Monitorim dhe identifikim i kongestionit pulmonary, 2-Sonde atriale bipolare me fiksion aktiv, e veshur me steroide, 3- Sonde ventrikulare bipolare me fiksion aktive e veshur me steroide, 4 - Sonde ventrikulare bipolare e veshur me steroide per stimulimin e ventrikulit te majte nepermjet sinusit koronar, me mundesi per implantim CS "mbi tel" dhe me mundesi zgjedhje midis 2 gjatesive te sondave si dhe te dy tipeve te ndryshme fiksimi ne anen distal. 5-Kateter per futjen ne sinusin koronar, me mundesi zgjedhje te formave te ndryshme. 6-Set aksesoresh per futjen ne sinusin koronar I cili konsiston:giden, sliter tool, shiringen dhe torque. 7-kateter me ballon per venogramen e sinusit koronar me mundesine e e futjes "mbi tel" .7-3sheath peel away per futjen e e sondave ku 2 nga keto 7 french dhe njera 9 french	copë
2	<b>Biventricular defibrilator(CRT- D) with corresponding leads ( compatible right Ventricular Lead, Atrial Lead , left Ventricular Lead , Coronary sinus cannulation set , Balloon catheter for CS ), and technical support during implantation and proctor. - CRT-D device including the following features:Arrhythmia detection in 3 zones ( VT, FVT and VF ), ATP therapy delivered before and during the capacitor charging , Independent programming of LV and RV pacing parameters, Independent dual zone rate response programming for normal workload and high physical exercise or is single slop, Minimum 3 pacing vectors in LV, Algorithm for ensuring CRT during ventricular sense events or algorithm synchronies LV pacing with RV intrinsic, Programmability of at least 2 different RV sensing vectors for VT/VF detection, Patient sound alarm or vibration in case of battery depletion and lead dysfunction, SVT discriminator based on far-field morphology, sound or vibration alarm in case of battery depletion or any other condition Biventricular defibrilator( CRT - D ) with corresponding leads ( compatible right Ventricular Lead, Atrial Lead , left Ventricular Lead , Coronary sinus cannulation set , Balloon catheter for CS ), and technical support during implantation and proctor. - CRT-D device including the following features:Arrhythmia detection in 3 zones ( VT, FVT and VF ), ATP therapy delivered before and during the capacitor charging , Independent programming of LV and RV pacing parameters, Independent dual zone rate response programming for normal workload and high physical exercise or is single slop, Minimum 3 pacing vectors in LV, Algorithm for ensuring CRT during ventricular sense events or algorithm synchronies LV pacing with RV intrinsic, Programmability of at least 2 different RV sensing vectors for VT/VF detection, Patient sound alarm or vibration in case of battery depletion and lead dysfunction, SVT discriminator based on far-field morphology, sound or vibration alarm in case of battery depletion or any other condition. Defibrilator biventricular (CRT - D) me sondat dhe sheath korrespondues (Sonden e ventrikulit të djathtë,sonden atriale,sonden e ventrikulit të majtë, set per kanjulinimin e sinusit koronar, kateter me balon për CS si dhe suport teknik dhe proctor gjatë implantimit). - CRT-D duhet te permbushi keto karakteristika: dedektim aritmise në 3 zona (takikardi ventrikulare (TV),takekardi</b>	cope



	ventrikulare e shpejte TVS) dhe Fibrilacion ventrikular (FV), terapi me pejsim antitakikardie (ATP) e aplikuar para dhe gjatë karikimit të kapacitatorit, Programim i pavarur i parametrave të parametrave të pejsimit të ventikutit të majte dhe të djathtë., Programim i pavarur i përgjigjes i frekuences me dy zona për ngarkese normale dhe aktivitet fizik të larte, të pakten 3 vektorë pejsues në ventrikulin e majte. Algoritmi për të siguruar CRT gjatë eventeve të sensimit ventrikulare ose algoritmi që sinkronizon pejsimin e VM me intrinsic e VD, Programueshmëri e të paktën 2 vektorëve sensimi në ventrikulin e djathtë për dedektimin e TV/FV, alarm për pacientin në rast harxhimi të baterise dhe disfunksionit të sondes, diskriminues i takikardise supraventikulare bazuar në morfologjine e far-field. Alarm me ze ose vibrim në rast të mbarimit të baterise ose fracture të sondes ose të një problemi tjetër.	
3	<b>Subselection catheter for LV Lead introduction into target vein with angled distal</b> (kateter subeselektiv për futjen e sondes së VM në një vene me kënd distal)	cope
4	<b>Pacing system analyser (PSA) restiriliable patient cable compatible with programer (kabeli i restirilizueshem që lidhet me programatorin dhe shërben si analizator për matjet gjatë implantimit të pacemakerit)</b>	
5	<b>Paper for programer</b> (leter për programatorin)	cope
6	left ventricular lead, different size AND curve,sonda për ventrikulin e majte me permassa dhe forma të ndryshme	cope
7	Catheter për hyrjen LV në sinus coronar, mundësinë e zgjedhjes së kthesave të ndryshme fundore distale	cope
8	MULTI POINT biventrikular DDDR a fib pacemaker, ruajtjen në programues të elektrogrameve intrakardiale në memorien e pajisjes për 14 minuta, me kalimin automatik të parametrave të tjere në baze aktivitetit të pacientit algoritmi për shtypjen e fibrilitit atrial me stimulim atrial në ritmin sinusal, stimulim i vecante i frekuences nderkohe që ndryshon mënyrën e përdorimit, algoritmin për stimulimin biventrikular të ruajtjes në rast të ndryshme në intervalin AV, zbulimin dhe monitorimin e mbingarkesës pulmonare, algoritme për optimizimin e AV, PV dhe vonesat VV, jetegjatesi me shumë se 6 vjet me 100% DDD MP pacing, 60ppm, A/RV/LV1/LV2=2.5V/0.4 ms, 500 om.Sonda kompatible atrial dhe pacing me fiksion	cope

#### LOTI 4 - PACEMAKER MRI COMPATIBLE / PACEMAKER TË PËRSHTATSHËM PËR MRI

Nr.	Materiali mjeksor me specififikimet teknike	Njësia
	<b>VVIR pacemaker with leads, MRI compatible: (full body scan)(Pacemaker VVIR me sonden që të jone kompatible me (MRI) rezonancën magnetike):</b>	
